



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Nr.389/9 Prot.

Tiranë, më 09/07/2016

V E N D I M

Nr. 92, Datë 09/07/2016

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË BASHKINË
POGRADEC “MBI ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË
FINANCIARE” PËR PERIUHDHËN 01.01.2015 deri 31.12.2015.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik , Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10, 15, dhe 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiarë” të ushtruar në Bashkinë Pogradec, për periudhën 01.01.2015 deri më 31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje na auditimi: Në Bashkinë Pogradec gjatë vitit 2015, janë marrë në punë 4 punonjës policie, nga të cilët 2 punonjës nuk plotësojnë kriteret ligjore. Aktiviteti i policisë Bashkiake, nuk është i dokumentuar me programe pune vjetore dhe mujore të miratuara nga Kryetari i Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me nenin 4, të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë Bashkiake", të ndryshuar dhe pika 11, të Rregullores së Brendshme “TIP” të Policisë Bashkiake dhe Komunës miratuar me Urdhrin e Përbashkët të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Ministrisë së Rendit Publik nr. 1, datë 17.04.2003 “Për miratimin e rregullores TIP të policisë Bashkiake dhe të komunës”.

1.1. Rekomandimi: Policia Bashkiake të marrë masa, që të hartojë programe pune mujore dhe vjetore të miratuara nga Kryetari i Bashkisë, si dhe të rris performancën me pjesëmarrjen e saj në ndihmë të aktiviteteve të strukturave të tjera të Bashkisë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Pogradec, 6-mujorin e dytë të vitit 2015, në kuadrin e reformës administrative ka rishikuar treguesit financiarë për 7 ish-komuna (duke përfshirë

edhe shpenzimet e deleguara), në shumën 1,121,843 mijë lekë. Treguesit e buxhetit për shpenzimet janë realizuar në shumën 706,045 mijë lekë ose 63 % e tyre, ndërsa të ardhurat janë realizuar në masën 81 %, por duke mos programuar shpenzime për investime.

Sipas bilancit të konsoliduar me ish- komunat, gjendja e kreditorëve në fund të vitit është në shumën 386,182,352 lekë, kërkesat debitore janë në shumën 56,822,655 lekë dhe detyrimet janë në shumën 329,359,697 lekë ose sa 50 % i totalit të shpenzimeve të Bashkisë me njësitë vartëse të saj (pa shpenzimet e deleguara), pra borxhi është akumuluar në periudhën 2010-2015 si rezultat i keq menaxhimit, veprim në papajtueshmëri me nenin 19, të ligjit nr. 8652, datë 31.10.2000 “Për Qeverisjen Vendore”, të ndryshuar, neni 6, ligjit nr. 9936, datë 26.8.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, UMF nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” dhe UMF nr. 2, datë 9.01.2015 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015”.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, për të ulur borxhin duke minimizuar shpenzimet e personelit dhe njëkohësisht, duke rritur të ardhurat nga taksat në 7 Njësitë Administrative, si dhe të analizoj detyrimet kreditore duke përcaktuar radhën e pagesës së tyre me synim uljen e kostos së borxhit mbi bazën e riskut që mund të aplikojnë kreditorët.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Pogradec, nuk ka miratuar rregulloren e funksionimit të brendshëm, nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), nuk ka indentifikuar aktivet me risk, si dhe nuk ka emëruar koordinatorin e riskut. Nuk janë përcaktuar gjurmët e auditimit lidhur me aktivitetet menaxheriale të strukturave të Bashkisë, në ndarjen e detyrave, pasi Bashkia me njësitë vartëse ka 77 punonjës, ndërsa nëpunës civilë 25 % e tyre, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe Kreun III, pika 1, të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

3.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të miratoj rregulloren e funksionimit të brendshëm, të ngrijë Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), të identifikoj aktivet me risk, të emëroj koordinatorin e riskut dhe të përcaktoj gjurmët e auditimit në lidhje me aktivitetet menaxheriale të strukturave të Bashkisë, si dhe të bëjë ndarjen e detyrave.

Brenda muajit Shtator 2016

4. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Pogradec, nga 45 masa organizative të rekomanduara (nga të cilat 25 masa organizative për Bashkinë Pogradec dhe 20 masa organizative për ish-komunën Cërravë), janë zbatuar 38 masa organizative dhe janë të pa zbatuara 7 masa organizative. Nga 16 masa shpërblim dëmi në shumën 28,060,238 lekë (nga të cilat 15 masa shpërblim dëmi për Bashkinë Pogradec dhe 1 masë shpërblim dëmi për ish-komunën Cërravë), janë zbatuar 5 masa duke arkëtuar shumën 403,839 lekë dhe nuk janë zbatuar 11 masa në shumën 27,656,399 lekë.

Nga 44 masa disiplinore të rekomanduara (38 masa disiplinore për Bashkinë Pogradec dhe 6 masa për ish-komunën Cërravë), janë zbatuar 38 masa dhe nuk janë zbatuar 6 masa disiplinore. Nga APP-ja janë vendosur 6 masa administrative gjobë në shumën 1,460,000 lekë të cilat nuk janë zbatuar. Mos zbatimi i rekomandimeve të KLSH, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

4.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të hartojë program pune për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së si dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore dhe administrative për arkëtimin e shumës **27,656,399 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2016

5. Gjetje nga auditimi: Zyra e Regjistrimit të Aseteve, Lejeve dhe Autorizimeve në Bashkinë Pogradec, nuk ka bërë inventarizimin e pronave dhe regjistrimin e tyre në ZVRPP

Pogradec, si dhe Njësinë Administrative Dardhas, Udenisht, Çërravë, Velçan, Proptisht, nuk disponojn të dhëna mbi gjendjen e pronave të miratuar sipas listës që kalojnë në përdorim ose në pronësi të ish-njësive të pushtetit vendor, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, të ndryshuar, me VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, të ndryshuar.

5.1. Rekomandimi: Zyra e Regjistrimit të Aseteve, Lejeve dhe Autorizimeve në Bashkinë Pogradec të marrë masa, të bëjë inventarizimin e pronave dhe regjistrimin e tyre në ZVRPP Pogradec, si dhe Njësia Administrative Dardhas, Udenisht, Çërravë, Velçan, Proptisht, të hartojnë të dhënat mbi gjendjen e pronave të miratuar në përdorim ose në pronësi të ish-njësive të pushtetit vendor.

Brenda muajit Shtator 2016

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Pogradec për vitin 2015, të ardhurat nga taksat dhe tatimet për biznesin dhe familjet i ka realizuar në shumën 125,952 mijë lekë ose 29 % e tyre. Në Zyrën e Tatim Taksave mungojnë regjistrat për biznesin që ushtron aktivitetin në 7 ish-komuna, mungojnë të dhëna mbi numrin e familjeve për detyrimet e pa paguara si: tarifë ndriçimi, tarifë pastrim dhe gjelbërim, taksën e tokës bujqësore, si dhe ndaj debitorëve nuk janë aplikuar masat shtrënguese për urdhër bllokimi të llogarive bankare, konfiskim të pasurive etj, veprim në papajtueshmëri me nenin 22, 23, 24, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, nenin 90 dhe 93, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Kreu III, pika 1, të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

6.1. Rekomandimi: Zyra e Taksave në Bashkinë Pogradec të marrë masa, për arkëtimin dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore për 42 biznese debitore, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a. Tu dërgohen Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b. Ti kërkohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit vendosja e barrës siguroese, (për mjetet) dhe Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë) bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH” të ndryshuar.

c. Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH” të ndryshuar, ndaj tyre të llogariten kamat vonesa (gjobë në masën 0,06% të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë).

d. Drejtoria e taksave për mos pagesën e taksave në afat të aplikojë dënim me gjobë për pagesat e vonuara, në masën 0,06% kamat vonesë për çdo ditë vonesë por jo më tepër se 365 ditë, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, dt.19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

e. Nga Drejtoria e taksave të listohen në mënyrë elektronike **abonentët familjarë** dhe të meren masa për arkëtimin e taksës së tokës, taksës së popullatës, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, si dhe **të njoftohen** tatimpaguesit familjarë të Bashkisë Pogradec dhe 7 Njësitë Administrative, për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të Njoftim Vlerësimi me anë të Zyrës Postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, të banesave dhe tarifë ndriçimi, pastrim e gjelbërim.

Brenda muajit Shtator 2016

7. Gjetje nga auditimi: Zyra e Tatim Taksave në Bashkinë Pogradec, për vitin 2014 nuk ka marrë në dorëzim dokumentacionin nga 7 ish-komunat, ndërsa të ardhurat janë realizuar në shumën 50,822 mijë lekë ose 12 % e planit të të ardhurave. Njësia Administrative Buçimas, nuk ka arkëtuar të ardhura në shumën 754,864 lekë, ndërsa Njësia Administrative Udenisht nuk ka realizuar të ardhura në shumën 2,290,100 lekë.

Për vitin 2015 nga Njësia Administrative Buçimas, nuk janë arkëtuar të ardhurat në shumën 2,861,617 lekë, si dhe nga Njësia Administrative Udenisht, nuk janë arkëtuar të ardhurat në shumën 1,295,630 lekë, veprim në papajtueshmëri me nenin 22, 23, 24, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, nenin 90 dhe 93, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Kreu III, pika 1, të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

7.1. Rekomandimi: Zyra e Tatim Taksave në Bashkinë Pogradec të marrë masa, për të marrë në dorëzim dokumentacionin e tatim taksave nga 7 ish-komunat, të analizojë treguesit e realizimit të të ardhurave nga ish komunat me qëllim programimin sa më real të ardhurave të Bashkisë, si dhe të aplikoj sanksione ndaj subjekteve debitorë për taksat e pa arkëtuar, si dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e shumës **5,906,581 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2016

8. Gjetje nga auditimi: Inspektorati i Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit (IMKT), për ndërtimet pa leje ndërtimi në 6 raste në shumën 4,451,811 lekë, ka aplikuar gjobë, por nuk ka bërë arkëtimin e tyre. Për 3 ndërtime pa leje nuk ka marrë vendim për prishjen e tyre, si dhe nuk ka bërë denoncim në organet e Rendit dhe të Prokurorisë. IMKT në Bashkinë Pogradec, nuk disponon të dhëna mbi gjendjen e territorit dhe nderimeve pa leje në 7 Njësitë Administrative të saj dhe nuk ka kryer kontrollin e territorit në këto njësi administrative, veprim në papajtueshmëri me nenin 3, 11, 20 dhe 30, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar” dhe Kreu III, pika 1, të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo - territorial”.

8.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e gjobave në shumën **4,451,811 lekë**, si dhe për 3 ndërtime pa leje të nxjerr vendime për prishjen e tyre, si dhe të bëjë denoncim në organet e Rendit dhe të Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Pogradec. IMKT në Bashkinë Pogradec, të hartoj të dhënat mbi gjendjen e territorit dhe nderimeve pa leje në 7 Njësitë Administrative të saj dhe të kryej kontrollin e territorit në këto njësi administrative.

Brenda muajit Shtator 2016

9. Gjetje nga auditimi: Bashkia Pogradec për vitin 2014-2015, detyrimet kontraktuale për sipërfaqen pyjore në 10 raste me vlerë 24,971,892 lekë, i ka llogaritur më pak se sa tarifa e miratuar, duke lidhur kontrata me sipërfaqe më të vogël se sa miratimi i lejes minerar të shfrytëzimit të miratuar nga MEI dhe përkatësisht: Në Njësinë Administrative Udenisht, në 5 raste me vlerë 5,664,506 lekë; në Njësinë Administrative Çerrave, në 1 rast me vlerë 1,185,840 lekë; në Njësinë Administrative Velçan, në 2 raste me vlerë 32,800 lekë dhe në Njësinë Administrative Proptisht, në 2 raste me vlerë 5,602,800 lekë, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

9.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të ngrejë grup pune me specialistë për vlerësimin e kontratave për pasuritë e dhëna me qira për shfrytëzim minerar, gurore dhe për ndërtimin e objekteve të ndryshme, duke përcaktuar statusin juridik të pronës, sipërfaqen, llojin e bimësisë etj., si dhe për rivlerësimin e detyrimeve kontraktuale. Të kërkojë nga subjektet qiramarrëse, arkëtimin e shumës **24,971,892 lekë**, si diferencë e llogaritur më pak,

si dhe të kërkoj anulimin e kontratave dhe riformulimin e tyre duke parashikuar penaltitetet përkatëse.

Brenda muajit Shtator 2016

10. Gjetje nga auditimi: Nga ish-komuna Buçimas për vitin 2014-2015, për dhënien me qira të sipërfaqeve pyjor edhe kullosor dhe për mbarështim të florës së egër, kultivim të bimëve të ndryshme dhe gjah, janë lidhur 4 kontrata me sipërfaqe 285,080 m², ndërsa dhënia me qira nuk është bërë mbi bazën e projekteve konkurruese, veprim në papajtueshmëri me neni 17, të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”, me nenin 2 dhe 9, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar dhe pika 9, 10, 15, të UKM nr. 4, datë 22.04.2013 “Për përcaktimin e kritereve të konkurrimit dhe procedurat e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor publik”.

10.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të vlerësojë kontratat mbi dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore për mbarështim të florës së egër, kultivim të bimëve të ndryshme dhe gjah dhe të kërkojë nga subjektet përkatëse hartimin e projekteve konkurruese.

Brenda muajit Shtator 2016

11. Gjetje nga auditimi: Bashkia Pogradec për vitin 2015, nuk ka paguar detyrimet afatshkurtra në vlerën 333,007,918 lekë, nga e cila: llogaria 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 8,159,235 lekë me një trend në rritje krahasuar me vitin 2014 dhe llogaria 467 “Kreditore të ndryshëm” paraqitet në vlerën 270,424,243 lekë me një trend në rritje krahasuar me vitin 2014.

11.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të shqyrtojë detyrimet e saj ndaj kreditorëve duke nxjerrë përgjegjësinë përkatëse për arsye se gjendja e këtij posti në fund të vitit 2015 ka qenë në vlerën **333,007,918 lekë**, detyrime të cilat përbëjnë risk për pagesa të tepërta për kamatat ligjore për vonesën në pagimin e detyrimeve kontraktore të lindura nga data e zbatimit të kontratës e deri më datën e likuidimit të këtyre detyrimeve.

Brenda muajit Shtator 2016

12. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Pogradec nuk ka marrë masa konkrete dhe nuk ka koordinuar punën me strukturat përkatëse për përmirësimin e dokumentacionit, me qëllim evidentimin, klasifikimin dhe ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme në rrugë administrative dhe ligjore për arkëtimin e debitorëve, në vlerën 49,146,932 lekë, nga e cila llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet në vlerën 29,201,738 lekë.

12.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e shumës **49,146,932 lekë**, si dhe të sigurojë në vazhdimësi likuidimin e detyrimeve ndaj furnitorëve.

Brenda muajit Shtator 2016

13. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë e Financës me datë 15.08.2015, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton me gjendje debitorë në vlerën 16,977,151 lekë, ndërsa nga Bashkia nuk janë bërë përpjekjet e duhura për arkëtimin e tyre, veprim në papajtueshmëri me neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar.

13.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e debitorëve në shumën **16,977,151 lekë**, si dhe të sigurojë në vazhdimësi likuidimin e detyrimeve ndaj furnitorëve.

Brenda muajit Shtator 2016

14. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2015, në Bashkinë Pogradec faturat e papaguara janë në shumën 30,938,710 lekë, një pjesë e tyre është regjistruar në llogarinë 401-408 dhe 467 dhe një pjesë e faturave vijnë nga bashkimi i ish-komunave. Krijimi i detyrimeve ndaj furnitorëve për punë, mallra e shërbime dhe mos likuidimi i tyre, vjen në papajtueshmëri me

nenin 50 e 51, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor”, pika 101, të UMF nr. 2, datë 06. 02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

14.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të shqyrtojë detyrimet ndaj kreditorëve duke nxjerrë përgjegjësinë përkatëse në shumën **30,938,710 lekë**, detyrime të cilat përbëjnë risk për pagesa të tepërta për kamatat ligjore për vonesën në pagimin e detyrimeve kontraktore të lindura nga data e zbatimit të kontratës e deri më datën e likuidimit të këtyre detyrimeve.

Brenda muajit Shtator 2016

15. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Pogradec me datë 15.08.2015, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton me gjendje debitore në shumën **3,770,876 lekë**, ndërsa debitorë paraqiten dhe punonjës të komunave dhe nuk janë bërë përpjekje për arkëtimin e tyre, veprim në papajtueshmëri me nenin 6, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

15.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e shumës **3,770,876 lekë**, si dhe të sigurojë në vazhdimësi likuidimin e detyrimeve ndaj furnitorëve.

Brenda muajit Shtator 2016

16. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Pogradec faturat e pa likuiduara janë paraqitur në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Kjo llogari me datë 15.08.2015, paraqitet në shumën 13,914,142 lekë. Pjesë e këtyre të pagueshmeve mund të jenë kamatë vonesë ligjore në lidhje me pagesat e vonuara që Bashkia Pogradec mund të bëjë nga bashkimi me komunat, veprim në papajtueshmëri me nenin 50 dhe 51, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor” dhe pika 101, të UMF nr. 2, datë 06. 02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

16.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të shqyrtojë detyrimet ndaj kreditorëve duke nxjerrë përgjegjësinë përkatëse për arsye se gjendja e këtij posti në fund të vitit 2015 ka qenë në shumën **13,914,142 lekë**, detyrime të cilat përbëjnë risk për pagesa të tepërta për kamatat ligjore për vonesën në pagimin e detyrimeve kontraktore të lindura nga data e zbatimit të kontratës e deri më datën e likuidimit të këtyre detyrimeve.

Brenda muajit Shtator 2016

17. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Pogradec me datë 15.08.2015, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet me gjendje debitore në shumën 4,201,573 lekë, ndërsa Bashkia nuk ka bërë përpjekjet për arkëtimin e debitorëve, veprim në papajtueshmëri me germën g pika 2 neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 07.08.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar.

17.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e debitorëve në shumën **4,201,573 lekë**, si dhe të sigurojë në vazhdimësi likuidimin e detyrimeve ndaj furnitorëve.

Brenda muajit Shtator 2016

18. Gjetje nga auditimi: Në Drejtoria e Financës në Bashkinë Pogradec për vitin 2015, llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në shumën 735,773 lekë dhe llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqitet në shumën 5,365,526 lekë, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e të pagueshmeve janë nga ish-komunat, pasi nuk është paraqitur asnjë dokumentacion nga ana e tyre për arkëtimin e tyre, veprim në papajtueshmëri me germën g pika 2 neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 07.08.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar.

18.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të shqyrtojë detyrimet e saj ndaj kreditorëve duke nxjerrë përgjegjësinë përkatëse pasi në fund të vitit 2015 kjo llogari është në shumën **5,365,526 lekë**, detyrime të cilat përbëjnë risk për pagesa të tepërta për kamatat

ligjore për vonesën në pagimin e detyrimeve kontraktore të lindura nga data e zbatimit të kontratës e deri më datën e likuidimit të këtyre detyrimeve.

Brenda muajit Shtator 2016

19. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Pogradec për vitin 2015, 4 projekte me vlerën 1,555,000 lekë, nuk i ka paraqitur në llogarinë 202 “Studime e kërkime” por i ka paraqitur në llogarinë 404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, veprim në papajtueshmëri me germën g pika 2 neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 07.08.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar.

19.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kontabilizoj në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” në shumën **1,555,000 lekë**, duke e transferuar në debi të llogarive të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara për objektet e përfunduara.

Brenda muajit Shtator 2016

20. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë e Financës në Bashkinë Pogradec për vitin 2015, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet në shumën 295,696 lekë, ndërsa nga Bashkia nuk janë bërë përpjekjet për arkëtimin e tyre. Llogaria 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në shumën 9,373,715 lekë, llogaria 42 “Personel e llogari të lidhura me to”, paraqitet në shumën 338,640 lekë, llogaria 431 “Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa”, paraqitet në vlerën 59,760 lekë, llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në shumën 2,523,744 lekë, si dhe llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në shumën 1,652,233 lekë, veprim në papajtueshmëri me germën g pika 2 neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 07.08.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar.

20.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, të shqyrtojë detyrimet e saj ndaj kreditorëve duke nxjerrë përgjegjësinë përkatëse për arsye se gjendja e këtij posti në fund të vitit 2015 ka qenë në vlerën **1,652,233 lekë**, detyrime të cilat përbëjnë risk për pagesa të tepërta për kamatat ligjore për vonesën në pagimin e detyrimeve kontraktore të lindura nga data e zbatimit të kontratës e deri më datën e likuidimit të këtyre detyrimeve.

Brenda muajit Shtator 2016

21. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Pogradec me datë 15.08.2015, materialet e nxjerra jashtë përdorimit i ka bërë pa i regjistruar në ditarin e magazinës apo në ditarin e veprimeve të ndryshme, ndërsa llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton me gjendje debitorë në shumën 1,292,312 lekë, veprim në papajtueshmëri me germën g pika 2 neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 07.08.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar.

21.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative debitorëve në shumën **1,292,312 lekë** dhe të sigurojë në vazhdimësi likuidimin e detyrimeve ndaj furnitorëve.

Brenda muajit Shtator 2016

22. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë e Financës në Bashkinë Pogradec me datë 15.08.2015, llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqitet me gjendje debitorë në shumën 3,822,792 lekë, pjesë e këtyre të pagueshmeve mund të jenë kamatë vonesë ligjore për pagesat e vonuara, veprim në papajtueshmëri me germën g pika 2 neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 07.08.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar.

22.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të shqyrtojë detyrimet e saj ndaj kreditorëve duke nxjerrë përgjegjësinë përkatëse për shumën **3,822,792 lekë**, detyrime të cilat përbëjnë risk për pagesa të tepërta për kamatat ligjore për vonesën në pagimin e detyrimeve kontraktore të lindura nga data e zbatimit të kontratës e deri më datën e likuidimit të këtyre detyrimeve.

Brenda muajit Shtator 2016

23. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Pogradec, KVO-ja ka përdorur dy standarde në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të operatoreve ekonomik, duke skualifikuar OE [REDAKTUAR] sh.p.k me vlerë më të ulët se ofertat fituese, dhe për pasojë autoriteti kontraktor ka paguar më tepër në vlerën **416,600 lekë, e cila përbën dëm ekonomik të arkëtueshëm nga KVO-ja**, kjo shkelje ka rezultuar në tenderin e zhvilluar me objekt: “Blerje dru zjarri për institucionet shkollore të qytetit dhe njësisive administrative”, me fond limit 6.250.000 lekë, zhvilluar më datë 30.10.2015.

KVO-ja ka përdorur dy standarde në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të operatoreve ekonomik, duke skualifikuar operatorin ekonomik “[REDAKTUAR]” me vlerë më të ulët se ofertat fituese, (në tender janë paraqitur “[REDAKTUAR]” shpk me marzhe fitimi e shprehur në përqindje 12.8 % dhe “[REDAKTUAR]” me marzhe fitimi e shprehur në përqindje 9.9%) e për pasojë Autoriteti Kontraktor ka paguar më tepër në kualifikimin e ofertave në vlerën **120,834 lekë**, kjo shkelje ka rezultuar në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje karburanti (nafte) për institucionet shkollore të qytetit”, me fond limit 4,166,667 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 30.10.2015.

23.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike, për 2 procedurat e prokurimeve me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën **537,434 lekë**, duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

Brenda muajit Shtator 2016

24. Gjetje nga auditimi: Operatori ekonomik “[REDAKTUAR]” shpk nuk ka zbatuar pikën 5 të nenit 8 "Kontrolli i automjetit" të kontratës datë 09.04.2014, me objekt: “Blerje makinë teknologjike për pastrimin e territorit komuna Buçimas Pogradec”, me fond limit 1,666,666 lekë pa TVSh, në të cilin është përcaktuar: “.. kontraktuesi është i detyruar që brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i kontratës të kryej regjistrimin e mjetit sipas legjislacionit në fuqi pranë Drejtorisë së Transportit Rrugor me shpenzimet e veta dhe çdo pagesë në institucionet shtetërore për efekt të regjistrimit të këtij mjeti është në ngarkim të shitësit”, gjë që ka shkaktuar dëm ekonomik të arkëtueshëm në vlerën e taksave e tarifave të kalimit të pronësisë, kolaudimit, siguracionit etj., nga [REDAKTUAR] shpk.

24.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore nga [REDAKTUAR] shpk të kryej regjistrimin e mjetit pranë Drejtorisë së Transportit Rrugor, bazuar në pikën 5 neni 8 “Kontrolli i automjetit” të kontratës datë 09.04.2014, ka përcaktuar se çdo pagesë në institucionet shtetërore për efekt të regjistrimit të këtij mjeti është në ngarkim të shitësit”.

Brenda muajit Shtator 2016

25. Gjetje nga auditimi: Bashkia Pogradec, për miratimin e nismës për Planin e Përgjithshëm Vendor, nuk ka organizuar takime me publikun, nuk ka ngritur Forumin për Bashkërendimin e Planifikimit në nivel vendor, nuk ka organizuar takime me grupet e interesit dhe ekspertë të fushës, si dhe të dhënat nuk janë botuar në regjistrin e territorit. Në dosje nuk ndodhet deklarata e përputhshmërisë që konfirmon kryerjen e punimeve në përputhje me normat dhe standardet e sigurisë, si dhe dokumentacionit tekniko-ligjor është dërguar me mangësi për regjistrim në ZVRPP Pogradec, veprim në papajtueshmëri me pika 2 neni 42, 54, 55 e 56, të ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, kreu II, neni 9 dhe neni 13, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 79, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, me pika 9 e 10 neni 3, pika 4 neni 4 dhe neni 8, të VKM nr. 671, datë 29.07.2015 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit” dhe UKM nr. 1, datë 16.06.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e ndërtimeve”, të ndryshuar.

25.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, që për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, të organizoj takime me publikun, të ngrijë Forumin për

Bashkëndimin e Planifikimit në nivel vendor, të hartoj programe pune, të organizoj takime këshilluese me grupet e interesit dhe ekspertë të fushës dhe të dhënat ti botoj në Regjistrin e Territorit dhe të kërkojë nga subjektet ndërtuese **deklaratën e përputhshmërisë** që konfirmon kryerjen e punimeve në përputhje me normat dhe standardet e sigurisë, si dhe të plotësoj me dokumentacionin tekniko-ligjor dosjet në lidhje me miratimin e certifikatave të përdorimit.

Brenda muajit Shtator 2016

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në pikën 5 neni 13, pika 14 neni 43, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, **nga ana e titullarit të njësisë publike**, (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse (Vendimet ekzekutive) dhe të kërkohej në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim për shpërblimin e dëmit në vlerën **85,397,142 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Pogradec dhe 7 ish-komuna sot Njësi Administrative të Bashkisë, janë lidhur kontrata për dhënien me qira të aseteve pyje, kullota, sipërfaqe të objekteve ndërtimore si dhe kontrata të lidhura me subjektet juridike të cilat shfrytëzojnë pasuri minerare ose gurore sipas licencave të dhëna nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë (MEI). Bashkia Pogradec, nuk ka marrë në administrim nga ish komunat, sot njësi administrative e saj, kontratat që këto kanë lidhur me subjekte të ndryshme për dhënien me qira të aseteve dhe për rrjedhojë nuk ka organizuar punën për vjeljen e detyrimeve kontraktuale, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu III, pika 1.

Gjithsej, janë lidhur e janë në fuqi 123 kontrata për vitin 2014-2015, ndërsa nga 91 subjekte në shumën 26,332,813 lekë, nuk janë paguar detyrimet kontraktuale që përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe me nenin 850, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për kodin Civil”, të ndryshuar.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, të marrë në administrim nga ish komunat, sot Njësi Administrative të saj, kontratat të cilat kanë lidhur me subjekte të ndryshme për dhënien me qira të aseteve, në zbatim të kërkesave të VKM nr. 510, datë 10.6.2015.

-Bashkia Pogradec, të marrë masat dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për administrimin e kontratave për dhënien me qira të aseteve që ish komunat, kanë lidhur me të tretët dhe për vjeljen e detyrime kontraktuale në shumën **26,332,813 lekë** nga 91 subjekte sipas njësive administrative si më poshtë:

Bashkia Pogradec, për 1 subjekt në shumën 135,000 lekë;

Njësia Administrative Dardhas, për 4 subjekte në shumën 369,400 lekë;

Njësia Administrative Udenishtë, për 64 subjekte në shumën 9,471,503 lekë;

Njësia Administrative Buçimas, për 3 subjekte në shumën 3,100,000 lekë;

Njësia Administrative Cëravë, për 6 subjekte në shumën 2,272,670 lekë;

Njësia Administrative Velçan, për 5 subjekte në shumën 1,572,100 lekë;

Njësia Administrative Proptisht, për 7 subjekte në shumën 9,412,140 lekë.

Brenda muajit Tetor 2016.

2. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e faqes elektronike të Ministrisë së Energjetikës dhe Industrisë (MEI), mbi subjektet e pasura me leje për shfrytëzim minerar dhe që janë aktive

deri më datën 6.02.2016, si dhe nga deklaratimet e punonjësve të njësive administrative Udenishtë dhe Buçimas, konstatohet se kryejnë aktivitetin e tyre për shfrytëzimin mineralar 4 subjekte për të cilat nuk na u paraqitën kontrata të lidhura nga titullarët e ish komunave, ku këto subjekte zhvillojnë aktivitetin e tyre mineralar.

Nga të dhënat e faqes elektronike të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), konstatohet se këto subjekte kanë qenë aktiv për periudhën e auditimit. Nga të dhënat e faqes elektronike të Ministrisë së Energjetikës dhe Industrisë (MEI), konstatohet se këto subjekte, kanë leje për shfrytëzim mineralar. Këto subjekte, nuk kanë paguar detyrime për taksat lokale dhe detyrimet porsa shfrytëzojnë sipërfaqet pyjore që përdorin sipas lejes për shfrytëzim mineralar të miratuar nga MEI për vitet 2014 dhe 2015, në shumën 21,436,000 lekë, me dëm ekonomik për Bashkinë Pogradec:

- Në njësinë administrative **Udenisht**, 3 raste për vlerën 6,318,000 lekë në vit, subjekti "██████████" shpk me NIPT K74310602V, leja e shfrytëzimit mineralar nr. 981, datë 12.12.2006, sipërfaqja për shfrytëzim 0.1 km², vendburimi Damba, Udenisht, lloji i mineralit Hekur-Nikel, detyrimi vjetor i llogaritur 780,000 lekë. Subjekti "██████████" shpk me NIPT J 93711608 Q, leja e shfrytëzimit mineralar nr. 1242, data 14.09.2008, sipërfaqja për shfrytëzim 0.55 km², vendburimi Çervenaka Jug Lindore, lloji i mineralit Hekur-Nikel, detyrimi vjetor i llogaritur 4,290,000 lekë në vit. Subjekti "██████████" shpk me NIPT L 21707008 U, leja e shfrytëzimit mineralar nr. 665, data 04.09.2013, sipërfaqja për shfrytëzim 0.16 km², vendburimi Memlisht-4, lloji i mineralit Krom, detyrimi vjetor i llogaritur 1,248,000 lekë.

- Në njësinë administrative **Buçimas**, në 1 rast, për subjektin: "██████████" shpk me NIPT J 73804663 H, leja e shfrytëzimit mineralar nr. 609, data 16.03.2001, sipërfaqja për shfrytëzim 0.1 km², vendburimi Hija e Zezë, lloji i mineralit Krom, detyrimi vjetor i llogaritur 4,400,000 lekë.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të ngrëjë grup pune me ekspertë të fushës si hartografë, specialistë të pyjeve, kullotave dhe kadastrës urbane, me qëllim:

- vlerësimin e rasteve, porsa subjektet e mësipërme kryejnë aktivitetin e shfrytëzimit mineralar pa lidhur kontratë me njësinë e qeverisjes vendore duke llogaritur detyrimeve kontraktuale sipas tarifave ligjore.

- lidhjen e kontratave porsa subjektet kryejnë aktivitetin e shfrytëzimit mineralar, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin mineralar", të ndryshuar neni 4.

- të kërkojë nga subjektet e sipërcituara arkëtimin e shumës **21,436,000 lekë**, si dëm i llogaritur nga miratimi i lejes për shfrytëzimin mineralar, pasi kanë shfrytëzuar sipërfaqet e pyjeve dhe kullotave.

Brenda muajit Tetor 2016.

3. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Pogradec për vitin 2015, anëtarët e Këshillit të Bashkisë në 34 raste në shumën 464,514 lekë, janë shpërblyer pa marrë pjesë në mbledhjet e këshillit, veprim në papajtueshmëri me pikën 2 neni 29, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Pogradec të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative për arkëtimin e shumës **464,514 lekë**, nga 34 persona sipas listës emërore trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajit Tetor 2016.

4. Gjetje nga auditimi: Në transaksionin nr. 42, datë 27.02.2015, me vlerë 1,910,404 lekë me objekt: "Situacion pastrimi Janar 2015", fatura tatimore nr. 1, datë 31.01.2015 dhe situacioni për periudhën 16.01.2015-31.01.2015, nuk është bazuar në DST (lidhja A, B) dhe kontratën datë 16.01.2015, duke shtuar zërat e shërbimeve në vlerën 307,575 lekë.

- Në transaksionin nr. 95, datë 21.04.2015, me vlerë 1,000,000 lekë me objekt: "Pastrimi i qytetit muaji Mars 2015), zëri "Mirëmbajtje lumi i qytetit" muaji Mars 2015 është situacionuar me afat 31 ditë ose më tepër 6.83 ditë, me diferencë në vlerën 16,037.50 lekë, në

kundërshtim me kontratën datë 16.01.2015, pasi në kontratë është parashikuar volumi 290 ditë/vit ose 24.17 ditë/muaj.

- Në transaksionin nr. 109, datë 11.05.2015, me vlerë 1,000,000 lekë me objekt: "Pastrimi i Qytetit" datë 01.03.2015-31.03.2015, zëri "Ngarkim + transport të ngurtash" muaji Mars 2015, është situacionuar me volum 66 ton ose + 12.66 ton më tepër me vlerë 21,794 lekë, në kundërshtim me kontratën datë 16.01.2015, pasi në kontratë është parashikuar volumi 700 ton/vit ose 53.34 ton/ muaj.

- zëri "Pastrim lumi i Qytetit dhe lumit të Vërdovës nga mbeturinat" në muajin Mars 2015, është situacionuar për 31 ditë ose më tepër 6 ditë me vlerë 14,089 lekë, në kundërshtim me kontratën datë 16.01.2015, pasi në kontratë janë parashikuar 290 ditë në vit ose 24-25 ditë në muaj, në vlerën 359,495 lekë, që përbën dëm ekonomik i arkëtueshëm nga Operatori Ekonomik "[REDACTED]" shpk.

4.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e shumës **359,495 lekë**, nga operatori ekonomik "[REDACTED]" shpk, si vlerë e situacionuar më tepër.

Brenda muajit Tetor 2016

5. Gjetje nga auditimi: Në transaksionin nr. 110, datë 11.05.2015, me vlerë 900,397 lekë me objekt: "Pastrimi i qytetit muaj Gusht 2012, zëri i shërbimit "Ngarkim + transport mbeturina familjare" në muajin Gusht 2012, është situacionuar me volum 1060 ton ose më tepër 130 ton, me vlerë 101,341.50 lekë, në kundërshtim me kontratën datë 22.12.2008, ndryshuar me shtesën e kontratës datë 21.08.2009, pasi në kontratë është parashikuar volumi 30 ton/ditë x 31 ditë ose 930 ton.

- zëri i shërbimit "Ngarkim + transport të ngurtash" në muajin Gusht 2012, është situacionuar me volum 220 ton ose më tepër 28.33 ton me vlerë 17,959 lekë, në kundërshtim me kontratën datë 22.12.2008, ndryshuar me shtesën e kontratës datë 21.08.2009, pasi në kontratë është parashikuar volumi 2300 ton/vit ose 191.67 ton/muaj.

- zëri shërbim "Mirëmbajtje lumi i qytetit" në muajit Gusht 2012 është situacionuar me afat 31 ditë ose më tepër 10.58 ditë me vlerë 23,995 lekë, në kundërshtim me kontratën datë 22.12.2008, ndryshuar me shtesën e kontratës datë 21.08.2009, pasi në kontratë është parashikuar volumi 245 ditë/vit ose 20.42 ditë/muaj.

- Në transaksionin nr. 916, datë 31.12.2015, me vlerë 1,539,776 lekë me objekt: "Pastrimi i Qytetit" për datën 01.01.2015-15.01.2015, zëri i shërbimit "Ngarkim + transport mbeturina familjare" në muajin janar 2015, është situacionuar me volum 480 ton ose më tepër 30 ton me vlerë 23,986.50 lekë, në kundërshtim me kontratën datë 22.12.2008, ndryshuar me shtesën e kontratës datë 21.08.2009, pasi në kontratë është parashikuar volumi 30 ton/ditë x 15 ditë ose 450 ton.

- zëri i shërbimit "Ngarkim + transport te ngurtash" në muajin janar 2015, është situacionuar me volum 202 ton ose më tepër 106.16 ton me vlerë 67,297 lekë, në kundërshtim me kontratën datë 22.12.2008, ndryshuar me shtesën e kontratës datë 21.08.2009, pasi në kontratë është parashikuar volumi 2300 ton/vit ose 95.84 ton/15 ditë në shumën 235,209 lekë, që përbën dëm ekonomik të arkëtueshëm nga Operatori Ekonomik "Pastër" shpk.

5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e shumës **235,209 lekë**, nga operatori ekonomik "[REDACTED]" shpk, si vlerë e situacionuar më tepër.

Brenda muajit Tetor 2016

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Pogradec, në 9 raste pagesën e energjisë elektrike e ka bërë jashtë afateve ligjore për të cilën OSHEE ka aplikuar kamat vonesa në shumën 392,831 lekë, që përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi nëpunësin zbatues dhe autorizues për mos derdhje në kohë të detyrimeve të energjisë, veprim në papajtueshmëri me germa f neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të

ndryshuar dhe UKM nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik”, të ndryshuar.

6.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **392,831 lekë**, nga nëpunësit autorizues e zbatues sipas afateve të qëndrimit në këtë funksion, e cila përfaqëson shumën e kamat vonesave të energjisë elektrike.

Brenda muajit Tetor 2016

7. Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Udenisht, sot Njësi Administrative e Bashkisë Pogradec, në 15 raste pagesën e energjisë elektrike e ka bërë jashtë afateve ligjore për të cilën OSHEE ka aplikuar kamat vonesa në shumën 28,471 lekë, që përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi nëpunësin zbatues dhe autorizues për mos derdhje në kohë të detyrimeve të energjisë, veprim në papajtueshmëri me germën f neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe UKM nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik”, të ndryshuar.

7.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **28,471 lekë**, nga nëpunësit autorizues e zbatues sipas afateve të qëndrimit në këtë funksion, e cila përfaqëson shumën e kamat vonesave të energjisë elektrike.

Brenda muajit Tetor 2016

8. Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Çerrave, sot njësi Administrative e Bashkisë Pogradec në 10 raste, pagesën e energjisë elektrike e ka bërë jashtë afateve ligjore për të cilën OSHEE ka aplikuar kamat vonesa në shumën 10,083 lekë, që përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi nëpunësin zbatues dhe autorizues për mos derdhje në kohë të detyrimeve të energjisë, veprim në papajtueshmëri me germën f neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe UKM nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik”, të ndryshuar.

8.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **10,083 lekë**, nga nëpunësit autorizues e zbatues sipas afateve të qëndrimit në këtë funksion, e cila përfaqëson shumën e kamat vonesave të energjisë elektrike.

Brenda muajit Tetor 2016

9. Gjetje nga auditimi: Bashkia Pogradec në 11 raste, për mos derdhje në kohë të detyrimeve tatimore ka paguar shpenzime "Interes për detyrimin e muajit Mars, Prill, Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor 2013, Janar 2014 dhe Maj 2014", për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, në shumën 194,520 lekë, e cila përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi nëpunësit zbatues dhe autorizues, veprim në papajtueshmëri me germën f neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe UKM nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik”, të ndryshuar.

9.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **194,520 lekë**, nga nëpunësit autorizues e zbatues sipas afateve të qëndrimit në këtë funksion, e cila përfaqëson shumën e interesave për pagesë të vonuar të detyrimeve tatimore.

Brenda muajit Tetor 2016

10. Gjetje nga auditimi: Bashkisë Pogradec në 11 raste, ka paguar kamatë vonesa për Ndërmarrjen e Ujësllësit në shumën 14,675 lekë, që përbën dëm ekonomik, veprim në papajtueshmëri me germën f neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe UKM nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik”, të ndryshuar.

10.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **14,675 lekë**, nga nëpunësit

autorizues e zbatues sipas afateve të qëndrimit në këtë funksion, e cila përfaqëson shumën e kamat vonesave të likuidimit të faturave të Ujësjellësit Pogradec.

Brenda muajit Tetor 2016

11. Gjetje nga auditimi: Në transaksionin nr. 130, datë 10.07.2014, me vlerë 4,637,388 lekë me objekt: "Rikonstruksion i Shkollës së Mesme Trebinjë", Autoriteti Kontraktor për moszbatimin në afat të kontratës ndaj Operatorit Ekonomik "██████████" shpk, **nuk ka aplikuar penalitete** në shumën 7,922,112 lekë, veprim në kundërshtim me kontratën ku është përcaktuar afati 90 ditë kalendarike nga nënshkrimi i kontratës ose data 28.12.2012.

11.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e shumës **7,922,112 lekë**, nga operatori ekonomik "██████████" sh.p.k, e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penalitetëve, në kontratën me objekt "Rikonstruksion i Shkollës së Mesme Trebinjë".

Brenda muajit Tetor 2016

12. Gjetje nga auditimi: Në transaksionin nr. 176, datë 11.09.2014 me vlerë 385,700 lekë me objekt: "Materiale kancelari dhe të tjera", zhvilluar më datën 25.03.2014, prokurimi duhej të ishte anuluar për arsye se, operatori fitues "██████████", është renditur i 11 në bazë të kriterit të çmimit. Komisioni Prokurimit me Vlera të Vogla duhej të merrte në konsideratë operatorët deri në vendin e 5 në renditje, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 137,700 lekë, të arkëtueshëm nga KPVV, veprim në kundërshtim me pikën 5, neni 40, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar -Në objektin: "Blerje materiale për shkolla dhe zyra", me fond limit me vlerë 262,000 lekë zhvilluar me datë 03.04.2014, Operatori Ekonomik fitues "██████████" me vlerë 256,680 lekë, Komisioni Prokurimit me Vlera të Vogla kanë skualifikuar 18 operator ekonomike në procedurë elektronik të zhvilluar më 17.03.2014 dhe 19 OE në procedurën e zhvilluar me datë 27.03.2014, veprim në kundërshtim me pika 5, neni 40, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, pasi në këtë fazë operatorët ekonomik nuk paraqesin në sistem dokumentet e pranimit kualifikimit, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 113,480 lekë të arkëtueshme nga anëtarët e komisionit të prokurimeve me vlera të vogla.

12.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative për arkëtimin e shumës **251,180 lekë**, nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël: F.F, N.S, dhe H.S, pasi në cilësinë e anëtarëve të Komisioni Prokurimit me Vlera të Vogla, kanë s`kualifikuar operatorët ekonomik në kundërshtim me dispozitat e prokurimeve publike për arsye se, në këtë fazë asnjë operator ekonomik përfshi edhe ofertuesin e shpallur fitues nuk kanë paraqitur në sistem dokumentet e pranimit kualifikimit.

Brenda muajit Tetor 2016

13. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës në 5 raste me vlerë 1,165,000 lekë, me objekt: "Projekte" në faturat e thjeshta tatimore subjekti "██████████" shpk ka përlllogaritur dhe vlerën e TVSH, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 194,166 lekë, të arkëtueshëm nga Operatori Ekonomik "██████████" shpk, veprim në kundërshtim me nenin 46, 47, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, pika 49 kreu VI, të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, neni 36, të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar dhe pika 7 kreu I, të Udhëzimit nr. 32, datë 31.12.2013 "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", të ndryshuar.

13.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e shumës **194,166 lekë**, nga operatori ekonomik "██████████" shpk, paguar më shumë.

Brenda muajit Tetor 2016

14. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës në 4 rastet, për operatorët fitues u verifikuan ekstraktet e QKR-së dhe rezultoi mospërputhje e objektit të veprimtarisë me objektin e prokuruar dhe në 11 raste punimet e ndërtimit të realizuara me procedurë prokurimi me vlera të vogël, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni teknik për kryerjen e punimeve.

Në transaksionin nr. 204, datë 07.07.2015 janë kryer pagesa për objektin “Projektim i rrugës “Sistemim asfaltim Slabinjë-Qafa e Losnikut” me vlerë 155,109 lekë, subjektit “██████████” shpk sipas faturës së thjeshtë tatimore nr. 6, datë 20.09.2012, me vlerë 400,000 lekë, i është llogaritur dhe TVSH në shumën 80,000 lekë, duke shkaktuar dëm ekonomik, në kundërshtim me nenin 46, 47, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pika 49 kreu VI, të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 36, të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, dhe pika 7 kreu I, të Udhëzimit nr. 32, datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”.

14.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **80,000 lekë**, nga operatori ekonomik “██████████” shpk, paguar më shumë.

Brenda muajit Tetor 2016

15. Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Dardhas, për vitin 2015, ka likuiduar shpenzime gjyqësore në shumën 379,500 lekë, në favor të shoqërisë përmbarimore “616/A” për 2 (dy) punonjës të larguar nga ky institucion. Shoqëria Përmbarimore “616/A” ka përllogaritur kërkesën (Titullin Ekzekutiv) për dëmshpërblim drejtuar komunës Dardhas mbi pagën bruto për të dy rastet në shumën 27,500 lekë/muaj sipas vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, ndërkohë që vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit ishte që ky dëmshpërblim të paguhet mbi bazën e pagës neto (përllogaritur 27,500 lekë/muaj – 11.2% 3,080 lekë/muaj = 24,420 lekë/muaj), duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 42,504 lekë.

15.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **42,504 lekë**, nga shoqërisë përmbarimore “616/A” sa paguar më tepërt.

Brenda muajit Tetor 2016

16. Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Ceravë në kontratën me objekt: “Projektim sistemim asfaltim rrugë të brendshme fshati Leshnicë”, nr. 33, datë 30.08.2009, me vlerë 190,000 lekë, operatori ekonomik nuk ka zbatuar afatin 4 mujor të dorëzimit të projektzbatimit. AK nuk ka llogaritur penalitete për dorëzim të vonuar të projektit në vlerën 342,000 lekë (190,000 lekë x 4/1000 x 450 ditë). "Projektim sistemim asfaltim rruga Demokracia fshati Çerrave", me vlerë 350,000 lekë, rezultoi se operatori ekonomik nuk ka zbatuar afatin 4 mujor të dorëzimit të projektzbatimit. Autoriteti Kontraktor nuk ka llogaritur penalitete për dorëzim të vonuar të projektit në vlerën 225,000 lekë (350,000 lekë x 4/1000 x 161 ditë).

16.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **567,000 lekë**, nga operatori ekonomik “██████████” shpk, për moszbatimin e penalitetëve sipas kërkesave të kontratës me objekt: "Projektim sistemim asfaltim rruga brendshme fshati Leshnicë" dhe "Projektim sistemim asfaltim rruga Demokracia fshati Çerrave".

Brenda muajit Tetor 2016

17. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës në transaksionin nr. 169, datë 07.07.2015, me vlerë 200.000 lekë me objekt: “Blerje materiale elektrike”, nuk ka hartuar procesverbal për llogaritjen e fondit limit, nuk ka kërkesë për prokurim, nuk është miratuar nga titullari, nuk ka procesverbal për marrjen në dorëzim të mallit nga komisioni. Prokurimi duhet të ishte anuluar, pasi operatori fitues ██████████ është renditur i 9 në bazë të kriterit të çmimit. Komisioni i Prokurimit me Vlerë të vogël duhet të merrte në konsideratë operatorët deri në vendin e 5 në renditje, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 31,112 lekë, të arkëtueshëm

nga KPVV, E.H, I.E, dhe N.S, veprim në kundërshtim me pika 5 neni 40, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

17.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **31,112 lekë**, nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël: E.H, I.E, dhe N.S, pasi në cilësinë e anëtarëve të KPVV, kanë s`kualifikuar operatorët ekonomik në kundërshtim me dispozitat e prokurimeve publike për arsye se, në këtë fazë asnjë operator ekonomik përfshi edhe ofertuesin e shpallur fitues nuk kanë paraqitur në sistem dokumentet e pranimit kualifikimit.

Brenda muajit Tetor 2016

18. Gjetje nga auditimi: Operatori ekonomik [REDAKTUAR] në vlerën 1,435,300 lekë, në një objekt jashtë projektit që nuk është në pronësi të ish komunës po të Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe pa marrë miratimin nga hartuesi i projektit dhe ARRSH, që përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi F.C, E.G, dhe ish-titullari i AK R.T, duke vepruar në kundërshtim me kreun III projektimi, mbikëqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe kontratën datë 20.10.2014 me objekt: “Pyllëzim kurora e gjelbër fshati Tushemisht”.

18.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **1,435,300 lekë**, nga: F.C, E.G, dhe ish-titullari i Autoritetit Kontraktor Roshi Tollozhina, për arsye se kanë miratuar ndryshimin e PZ, duke investuar në një objekt jashtë projektit dhe që nuk është në pronësi të ish-komunës po të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

Brenda muajit Tetor 2016

19. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e zhvilluar me objekt "Pyllëzim kurora e gjelbër fshati Tushemisht" me fond limit 18,729,530 lekë Bashkimi i operatorëve ekonomik “[REDAKTUAR]”, nuk kanë realizuar në kohë kontratën datë 20.10.2014, në të cilin është përcaktuar afati i lëvrimit 60 ditë nga nënshkrimi i kontratës ose datë 20.12.2014. Autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar kushtet e kontratës në lidhje me aplikimin e dëmeve për mos zbatim në kohë të punimeve, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 8,170,009 lekë në vit të arkëtueshëm nga BOE “[REDAKTUAR]” & “[REDAKTUAR]”.

19.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **8,170,009 lekë** në vit, nga operatori ekonomik “[REDAKTUAR]” shpk që përfaqëson shumën e moszbatimit të penalitetëve në tenderin me objekt “Pyllëzim kurora e gjelbër fshati Tushemisht”.

Brenda muajit Tetor 2016

20. Gjetje nga auditimi: KVO-ja në ish-Komunën Buçimas kanë përdorur dy standarde të ndryshme në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të operatoreve ekonomik në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje makinë teknologjike për pastrimin e territorit komuna Buçimas Pogradec”, me fond limit 1,666,666 lekë pa TVSh, duke s`kualifikuar OE me vlerë më të ulët se ofertat fituese, e për pasojë autoriteti kontraktor ka paguar më tepër në vlerën **266,100 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik të arkëtueshëm nga KVO-ja.

20.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **266,100 lekë**, nga anëtarët Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për arsye se, në cilësinë e anëtarëve të KVO-së, P.K, R.Ç, dhe E.M, kanë përdorur dy standarde të ndryshme në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të operatoreve ekonomik, në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje makinë teknologjike për pastrimin e territorit komuna Buçimas”, duke s`kualifikuar operatorin ekonomik me vlerën më të ulët se ofertat fituese.

Brenda muajit Tetor 2016

21. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje dru zjarri”, me fond limit 458,333 lekë pa TVSh, zhvilluar me datë 30.04.2014, operatori ekonomik nuk ka plotësuar në

afat kontratën, në kundërshtim me Formularin e Njoftimit të Kontratës, sasia dhe grafiku i lëvrimin dhe ofertën e operatorit ekonomik në të cilin përcaktohet afatet e lëvrimin 3 muaj nga nënshkrimi i kontratës, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **37,376 lekë**, të arkëtueshëm nga kontraktuesi “ADA-CO”, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, të ndryshuar dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar.

21.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **37,376 lekë**, nga Operatori Ekonomik “██████████” shpk e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penalitetëve, në tenderin me objekt “Blerje dru zjarri”.

Brenda muajit Tetor 2016

22. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje pompë uji”, me fond limit 666,667 lekë pa TVSh, zhvilluar me datë 02.05.2014”, KVO-ja ka përdorur dy standarde të ndryshme në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të operatoreve ekonomik, duke skualifikuar operatorin ekonomik “██████████” me vlerën më të ulët se ofertat fituese dhe për pasojë Autoriteti Kontraktor ka paguar më tepër vlerën 136,660 lekë, e cila përbën dëm ekonomik të arkëtueshëm nga KVO-ja, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, të ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar.

Në procedurën me objekt: “Rikonstruksion kanalizime Komuna Udënisht”, me fond limit 416,667 lekë pa TVSh, KVO-ja ka përdorur dy standarde të ndryshme në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të operatoreve ekonomik, duke skualifikuar OE me vlerë më të ulët se ofertat fituese, e për pasojë autoriteti kontraktor ka paguar më tepër në vlerën 36,746 lekë, e cila përbën dëm ekonomik të arkëtueshëm nga KVO, veprim në kundërshtim me kreu III projektimi, mbikëqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe kontratën përkatëse.

22.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **173,406 lekë**, nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave F.A, K.S, B.LI, për arsye se, KVO-ja kanë përdorur dy standarde të ndryshme në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të operatoreve ekonomik, duke s`kualifikuar operatorët ekonomik me vlerën më të ulët se oferta fituese.

Brenda muajit Tetor 2016

23. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion rruga e varrezave fshati Piskupat” me fond limit 2,333,334 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 30.03.2015, s`kualifikimi i Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “██████████” shpk, është bërë pasi KVO-ja ka përdorur dy standarde të ndryshme në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të operatoreve ekonomik, duke skualifikuar operatori ekonomik me vlerë më të ulët se ofertat fituese, e për pasojë autoriteti kontraktor ka paguar më tepër vlerën 221,800 lekë, e cila përbën dëm ekonomik të arkëtueshëm nga KVO, veprim në kundërshtim me nenin 66 Kreu VII, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion rruga hyrëse për tek shkolla Piskupat”, me vlerë limit 1,590,000 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 30.03.2015, skualifikimi i BOE “██████████” shpk është bërë, pasi KVO-ja ka përdorur dy standarde të ndryshme në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të operatoreve ekonomik, duke skualifikuar operatorin ekonomik me vlerë më të ulët se ofertat fituese, e për pasojë autoriteti kontraktor ka paguar më tepër në vlerën 208,000 lekë, që përbën dëm ekonomik të arkëtueshëm nga KVO, veprim në kundërshtim me nenin 66 Kreu VII, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar.

23.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **429,800 lekë**, nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave: F.A, P.S, A.Sh, për arsye se KVO-ja

kanë përdorur dy standarde të ndryshme në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të operatoreve ekonomik, duke s`kualifikuar operatorin ekonomik me vlerë më të ulët se oferta fituese.

Brenda muajit Tetor 2016

24. Gjetje nga auditimi: Në ish-Komunën Udenisht nuk administrohet asnjë dokumentacion në lidhje me instalimin e dy elektropompave të vaditjes dhe nuk është ngarkuar asnjë person përgjegjës për administrimin e tyre, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 799,920 lekë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", të ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar.

24.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **799,920 lekë**, duke nxjerr përgjegjësitë përkatëse dhe bërë sistemimet e nevojshme në pasqyrat financiare në zbatim të procedurave ligjore.

Brenda muajit Tetor 2016

25. Gjetje nga auditimi: Në kontratën datë 16.01.2015 është konstatuar se janë përfshirë gabimisht, duke u përsëritur dy herë rrugët "Gani Homçani" me sipërfaqe 3850 m² në zërat: Fshirje sipërfaqe rrugë të asfaltuara m² 3850 x 0.161 x 1825 = 1,131,226.25 lekë dhe Mirëmbajtje sipërfaqeve të asfaltuara m² 1570 x 0.074 x 910 = 105,723.80 lekë. Në totali në vlerën **1,236,950 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik të arkëtueshëm e duhet të zbritet nga kontrata datë 16.01.2015, veprim në kundërshtim me kreun III projektimi, mbikëqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar dhe "Lidhjen B" të kontratës datë 16.01.2015 me objekt: "Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave publike në qytetin e Pogradecit".

25.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec nëpërmjet një amendamenti të nënshkruar nga të dy palët nga vlera e kontratës lidhur datë 16.01.2015 me operatorin fitues "[REDAKTUAR]", për harkun kohor 5 vjeçar 2015-2020, nga vlera 166,148,333 lekë pa TVSh, të zbritet vlera **1,236,950 lekë**, pa TVSh, duke korigjuar sipërfaqen e rrugëve të dubluara në "Lidhjen B" të kontratës me objekt: "Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave publike në qytetin e Pogradecit".

Brenda muajit Tetor 2016

26. Gjetje nga auditimi: Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga mbikëqyrësi i kontratës rezulton se llogaritja e ndalesave mujore (Janar-Dhjetor 2015), për zërat e shërbimeve kryheshin me koeficientin 0.25%, 0.50, 0.75 dhe 100 %, duke mos zbritur gjithë volumin e shërbimit në masën 100% të volumit të pa kryer, duke mos u mbështetur në asnjë dispozitë ligjore apo kontratë volumet e shërbimeve zbriteshin në masën 0.25%, 0.50%, 0.75% të volumit të pa kryer. Nga rillogaritje e pagesave për të gjitha volumet e pakryera për vitin 2015, nuk janë kryer ndalesat duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 171,372 lekë, të arkëtueshëm nga operatori ekonomik "[REDAKTUAR]" shpk, veprim në kundërshtim me kreun III projektimi, mbikëqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar dhe "Lidhjen B" të kontratës datë 16.01.2015 me objekt: "Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave publike në qytetin e Pogradecit".

26.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **171,372 lekë**, nga operatori ekonomik "[REDAKTUAR]", për mos kryerjen e punimeve dhe shërbimeve në tenderin me objekt "Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave publike", sipas kontratës datë 16.01.2015, me afat deri më 16.01.2020.

Brenda muajit Tetor 2016

27. Gjetje nga auditimi: Lidhja e kontratës nr. 924, datë 29.10.2014, të nënshkruar ndërmjet kryetarit të Komunës Buçimas Roshi Tollozhina dhe operatorit ekonomik "[REDAKTUAR]" shpk me objekt: "Për depozitimin e mbeturinave urbane në territorin e Komunës Buçimas

Pogradec, në vendin e quajtur "Luadhi i Celos" është bërë në kundërshtim me vendimin e KM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", **pasi titullari i institucionit nuk ka zbatuar asnjë nga kriteret e përcaktuar në këtë vendim.**

Operatori ekonomik "██████████" shpk nuk ka paguar detyrime për marrjen me qira të fushës së depozitimit për një periudhë 5 vjeçare, konformë kontratës nr. 924, datë 29.10.2014 me objekt: "Për depozitimin e mbeturinave urbane në territorin e Komunës Buçimas Pogradec, e cila për një vit është në vlerën **10,594,800 lekë**, veprim në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore".

27.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **10,594,800 lekë**, nga operatori ekonomik "██████████", e cila përfaqëson detyrime për marrjen me qira të fushës së depozitimit për një periudhë 5 vjeçare sipas kontratës nr. 974, datë 29.10.2014 me objekt: "Për depozitimin e mbeturinave urbane në territorin e Komunës Buçimas Pogradec, në vendin e quajtur "Luadhi i Celos".

Brenda muajit Tetor 2016

28. Gjetje nga auditimi: Në objektin "Sistemim Sheshi Qendër Udenisht-Rruga Nacionale", ish-Komuna Udenisht, Pogradec, nga dokumentacioni teknik i zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera dhe përfitim më tepër në vlerën 2,504,424 lekë pa TVSH, veprim në papajtueshmëri me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", Kreu II, pikat 3, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, dhe pika 3.2 e 3.3, të Kontratës për mbikëqyrjen e punimeve të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Udenisht dhe mbikëqyrësit të punimeve.

28.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **2,504,424 lekë** pa TVSH, nga OE "██████████" shpk në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën datë 10.12.2014 me objekt "Sistemim Sheshi Qendër Udenisht-Rruga Nacionale", ish-Komuna Udenisht, Pogradec, për likuidimin e punimeve të pakryera.

Menjëherë

29. Gjetje nga auditimi: Në objektin "Kënd Sportiv për Shkollat e Fshatrave Lin, Piskupat e Buqez", ish-Komuna Udenisht, Pogradec, nga dokumentacioni teknik i zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera duke përfituar më tepër vlerën 1,419,800 lekë pa TVSh, pasi në objekt nuk është kryer asnjë lloj punimi, pra Kontrata rezulton e pa zbatuar, ndërsa objekti është likuiduar për gjithë vlerën që përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, UKM nr. 1, datë 16.06.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e ndërtimeve", të ndryshuar, Kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me AK ish-Komuna Udenisht, Pogradec dhe mbikëqyrësit të punimeve dhe Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin punimeve të ndërtimit".

29.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkoj në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **1,419,800 lekë** pa TVSH, nga Operatori Ekonomik "██████████" shpk në cilësinë e sipërmarrësve në Kontratën datë 11.11.2014 me objekt "Kënd Sportiv për shkollat e fshatrave Lin, Piskupat e Buqez", ish-Komuna Udenisht, Pogradec, për situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE:

C. I. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

- Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore” shkronja “b”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 germa **g** dhe **k** të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë që ti kërkojë Komisionit disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, **“Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”** parashikuar në nenin 58 shkronja (b), **për 2 punonjës** sa vijon:

1 – M.K., me detyrë Specialist për politikën ekonomike, në cilësinë ish-Nëpunës Zbatues **për shkelje në:**

- Ka prokuruar objekte për investime e shërbime dhe ka nënshkruar kontrata pa disponuar fonde, veprim në papajtueshmëri me nenin 50 dhe 51, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

- Për mos marrjen e masave dhe mos koordinimin e punës për evidentimin, klasifikimin dhe ndjekjen në rrugë administrative dhe ligjore për arkëtimin e “Kërkesave të arkëtueshme mbi debitorët”, në shumën **49,146,932 lekë**, nga e cila “Debitorë të ndryshëm” në shumën 29,201,738 lekë, veprim në papajtueshmëri me nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe pikën 61, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar.

- Në **10 raste** në vlerën **392,831 lekë**, janë kryer pagesa për “Kamat vonesë të pagesave të energjisë elektrike për periudhën Dhjetor 2014- Prill 2015, për Bashkinë Pogradec vlerë e cila përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi nëpunësit zbatues dhe autorizues për mos derdhje në kohë të detyrimeve të energjisë, veprim në papajtueshmëri me nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe pikën 61, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar.

- Në **11 raste** në vlerën **194,520 lekë**, janë kryer pagesa me objekt shpenzimi "Interes për detyrimin e muajit Mars, Prill, Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor 2013, Janar 2014 dhe Maj 2014”, paguar Drejtorisë së Përgjithshme Tatimeve Tiranë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi nëpunësit zbatues dhe autorizues për mos derdhje në kohë të detyrimeve tatimore, veprim në papajtueshmëri me nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe pikën 61, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar

2 – F.B., me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Administrimit të Aseteve, Lejeve dhe Autorizimeve, për shkeljet e mëposhtme;

-Nuk disponon të dhëna mbi gjendjen dhe administrimin e asetëve në lidhje me 7 ish-Komuna, sot Njësi Administrative të Bashkisë Pogradec; Çeravë, Dardhas, Trebinjë, Velçan, Buçimas, Proptisht dhe Udënisht.

-Nuk disponon të dhëna mbi vendimet që kanë marrë ish-këshillat e komunave për pronat n dhe regjistrimin e tyre, kontratat për dhënien me qira të asetëve dhe statusin juridik të tyre, veprim në papajtueshmëri me neni 8, 10, 15, 16, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”, të ndryshuar, pika 37, 42, 60, 74, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, të ndryshuar, dhe pika 1 Kreu III, të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”.

C. 2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germa e dhe ç neni 11, kreu IV, neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe neni 11 e 12, të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur dhënien e masave disiplinore “**Vërejtje**” deri në “**Zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës**”, për **3 punonjës** si më poshtë:

1 – C.B., me detyrë Drejtor i Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare, për periudhën datë 01.10.2015 e në vazhdim, pasi;

- Për mos zbatimin e procedurave ligjore në lidhje me kërkesë padi në gjykatë, sekuestrim malli ose kallëzim penal, për arkëtimin e vlerës 27,656,399 lekë, të rekomanduara nga KLSH-ja dhe nga auditimet e kaluara, ndërsa vlera 5,282,200 lekë nuk është arkëtuar nga ish-Komunës Çërravë, sot Njësi Administrative e Bashkisë Pogradec, veprim në papajtueshmëri me nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe pikën 61, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar.

- Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar dhe UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

- Nuk ka marrë masat e nevojshme për të krijuar bazën e të dhënave mbi subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tyre në 7 ish-Njësitë e Qeverisjes Vendore, sot Njësia Administrative të Bashkisë Pogradec, detyrimet për taksat e popullsisë, kontratat në fuqi për dhënien e aseteve me qira si dhe ndjekja e detyrimeve debitore.

- Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”, të ndryshuar, neni 8, 16, 19, të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të Qeverisjes vendore në republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 139, datë 2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 8, 9, 34, 35 dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Kreu III, pika 1.

2 – V.M., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave për periudhën 01.12.2015 e në vazhdim, për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos zbatimin e rekomandimeve të lënë nga KLSH-së dhe nga auditimet e mëparshme në shumën 18,482,200 lekë, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, me nenin 90 dhe 93, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar dhe UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3 – N.T., me detyrë Koordinator për Njësitë Administrative në Bashkinë Pogradec, ish-Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit për periudhën datë 19.8.2015 deri 29.02.2016, për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos marrjen e masave për Inspektimin dhe Kontrollin e Territorit, mos krijimin e bazës së të dhënave për subjektet që ushtrojnë aktivitetet dhe vjeljen e tatim taksat dhe mos administrimin e aseteve në Njësitë Administrative të Bashkisë Pogradec, veprim në papajtueshmëri me neni 8, 10, 15, 16, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”, të ndryshuar, pika 37, 42, 60, 74, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, të ndryshuar, dhe pika 1 Kreu III, të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e

të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

D. MASA ADMINISTRATIVE

D. 1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

- Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike në nenet 4, 12, 19/7, 21, 23, 25, 28, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 53, 56, 63, etj, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet nr. 6, 7, 8, 9, 10, 11 datë 08.02.2016, nr. 12, 13 dhe 14 datë 09.02.2016, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit. Mbështetur në nenin 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (**dënim me gjobë**) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (**për marrjen e masave disiplinore**), për **8 punonjës** si më poshtë:

1 – S.LI, me detyrë Specialist për prokurimet, në cilësinë e Juristes të Njesisë së Prokurimit publik, për shkelje e konstatuara në **6 procedura** të prokurimit publik.

2 – E.I, me detyrë Specialist i nivelit të lartë për rininë, në cilësinë e Juristes të Njesisë së Prokurimit publik, për shkelje e konstatuara në **6 procedura** të prokurimit publik.

3 – E.S, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Projekteve me Donatorët dhe Komunitetin, në cilësinë e Juristes të Njesisë së Prokurimit publik, për shkelje e konstatuara në **6 procedura** të prokurimit publik.

4 – F.B, me detyrë Specialist i nivelit të lartë për rininë, në cilësinë e Specialistes të Njesisë së Prokurimit publik, për shkelje e konstatuara në **6 procedura** të prokurimit publik.

5 – E.L, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit, Thesarit, Pagave dhe Arkës, në cilësinë e Specialistes të Njesisë së Prokurimit publik, për shkelje e konstatuara në **6 procedura** të prokurimit publik.

- Nuk kanë dhënë argumente të hollësishme mbi arsyet e vendosjes së çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me kreun III “Dokumentet e tenderit”, të miratuara me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet: “Për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike dhe në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës, duke nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, veçanërisht biznesit të vogël. Kriteret jo përpjesëtimore e të ekzagjeruar kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, mallrave dhe shërbimeve, për rrjedhojë autoriteti kontraktor ka paguar më shumë në kualifikimin e ofertuesve dhe përzgjedhjen e ofertuesit fitues, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimeve”.

- Nuk kanë vulosur nga dega e thesarit Urdhrat e Prokurimit Nr. 1, date 20.01.2015 me objekt "Blerje kuotë ushqimore për çerdhen e qytetit" në vlerën **126,880 lekë**, pa TVSH, nr. 6, datë 25.02.2015 me objekt: "Sistemim rrugësh blloku i lagjes Nr. 1, trekëndëshi" në vlerën **8,565,050 lekë**, pa TVSH, dhe Nr. 31, datë 21.12.2015, me objekt: "Grumbullimin dhe transportin e mbetjeve inerte të dala gjatë daljes nga shtrati i lumit të "qytetit Pogradecit" dhe lumi i fshatit "Vërdovë" në vlerën **998,481 lekë**, pa TVSH, në kundërshtim me Udhëzimin Plotësues të Ministrit të Financave nr. 2, datë 19.01.2015 "Për zbatimin e buxhetit të viti 2015", pika 27, ku përcaktohet: "Urdhri i Prokurimit që nxirren gjatë vitit për mallra, shërbime dhe investime duhet të paraqiten në degën e thesarit së bashku me Formularin e

Njoftimit të Kontratës të cilat duhet ti përmbahen listës së prokurimeve të dorëzuara në thesar, të kontrollohen për përputhshmërinë me regjistrin e prokurimeve dhe të vulosen nga dega e thesarit të rrethit, përpara procedimit, sipas rregullave të prokurimit publik".

6 – R.S., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Turizmit, në cilësinë e kryetarit të komisionit të trajtimit të ankesës.

7 – Z.C., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Arsimit, në cilësinë e anëtarit të komisionit të trajtimit të ankesës.

8 – P.Z., me detyrë ish-Drejtor i Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të komisionit të trajtimit të ankesës, larguar nga puna me datë 21.02.2015.

- Kanë kualifikuar operatorin ekonomik "██████████", në kundërshtim me nenin 46 dhe 53, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar dhe Kreun VII, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Kjo shkelje ka rezultuar në tenderin e zhvilluar me objekt "Blerje kuote ushqimore për çerdhen e qytetit 2015....", me fond limit në vlerën 998,120 lekë, zhvilluar më datë 19.03.2015.

D. 2. Për mangësitë e konstatuara në dokumentacionin ekonomiko-financiar dhe teknik në plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit të operatorit ekonomik, mangësi këto që mund të konsideroheshin devijime të vogla pasi nuk preknin dhe nuk ndikojnë në ekzekutimin e kontratës dhe nga ana tjetër kanë kualifikuar dhe shpallur fitues operator ekonomik kur dokumentacioni i paraqitur për të vërtetuar kapacitetet ekonomike, financiare dhe teknike është në kundërshtim me DST (Kriteret e Veçanta të Kualifikimit), neni 46 dhe 53, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar dhe Kreun VII, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, për **5 punonjës** si më poshtë:

1. N.T., me detyrë Koordinator, në cilësinë e anëtarit dhe kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

2. E.K., me detyrë Drejtor i Qendrës Arsimore, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

3. B.M., me detyrë Specialist personeli, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

4. M.B., me detyrë Nënkryetar, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

5. Ç.B., me detyrë Drejtor i Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt: "Blerje dru zjarri për institucionet shkollore të qytetit dhe njësisive administrative", dhe me objekt: "Blerje karburanti (nafte) për institucionet shkollore të qytetit", ka skualifikuar për mangësi të konstatuara në dokumentacionin ekonomiko financiar dhe teknik për plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi këto mangësi mund të konsideroheshin lehtësisht devijime të vogla sepse nuk preknin dhe nuk ndikojnë në ekzekutimin e kontratës dhe nga ana tjetër kanë kualifikuar dhe shpallur fitues operator ekonomik kur dokumentacioni i paraqitur për të vërtetuar kapacitetet ekonomike, financiare dhe teknike është në kundërshtim me DST (Kriteret e Veçanta të Kualifikimit), neni 46 dhe 53, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar dhe Kreun VII, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

E. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV), Bashkia Pogradec.

E. 1. Mbështetur në ligjin nr. 183/2014 datë 01.04.2013 "Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" dhe neni 15 "Sanksionet", të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar dhe bazuar në nenin 15 germa c dhe ç të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe

funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, i kërkojmë:

Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore të Bashkisë Pogradec, që të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur sanksionet “**Dënimin me gjobë**”, për **5** hartues të projektzbatimit si më poshtë:

1. **P.K.**, me detyrë Drejtor i Punëve Publike, në cilësinë e hartuesit të projektzbatimit.
2. **O.S.**, me detyrë Përgjegjës i Urbanistikës, në cilësinë e hartuesit të projektzbatimit
3. **V.B.**, subjekt me licencë, në cilësinë e hartuesit të projektzbatimit.
4. **A.A.**, subjekt me licencë, në cilësinë e hartuesit të projektzbatimit.
5. **B.B.**, në cilësinë e hartuesit të projektzbatimit.

- Nuk kanë kategorinë përkatëse në licencat profesionale sipas përcaktimeve të rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për hartimin e projekt zbatimit, në kundërshtim me nenin 5, kreu III “Projektimi, mbikëqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit” neni, të ligjit 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe VKM nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit të ndërtimit”.

E. 2. Bashkia Pogradec të marrë masa, që në mbështetje të nenit 12 Kreun III neni 15 dhe 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe pika 3 Kreu II, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, t’i kërkojë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, për **1 kolaudator** dhe **1 mbikëqyrës** të punimeve të vendosë masë **administrative gjobë** si më poshtë:

1 - Ing. E.T., në cilësinë e kolaudatorit të punimeve të vendosë masë **administrative gjobë në shumën 500,000 lekë**, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt: “**Sistemim Sheshi Qendër Udenisht – Rrua Nationale**”, ish-Komuna Udenisht, Pogradec, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të Shtetit në shumën 2,504,424 lekë pa TVSH, për **punime të pakryera**.

2- K.S., në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të firmës “**[REDAKTUAR]** Shpk, të vendosë masën **administrative gjobë në shumën 200,000 lekë**, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt: “**Sistemim i Rrugës Lagja Nr. 1 (Trekëndëshi) në Qytetin e Pogradecit**”, Bashkia Pogradec, si pasojë e mangësive nga punimet e pakryera, pasi në dosjen teknike të objektit mungon Kontrata e mbikëqyrjes së punimeve, si dhe dokumentacioni teknik i zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit.

E. 3. Nuk ka nënshkruar situacionet pjesore dhe përfundimtare në monitorimin e kontratës me objekt “Pyllëzim kurora e gjelbër fshati Tushemisht” me fond limit 18,729,530 lekë, në kundërshtim me Manualin e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave “Mbi rregullat dhe kërkesat teknike të trajtimit, përdorimit e shfrytëzimit të pyllit komunal”, Kapitulli III-të “Kontrolli dhe marrja në dorëzim e punimeve”, pasi grupi i specialistëve, i caktuar me urdhër të veçantë të drejtorit të DSHP Korçë, duhej të monitoronte punën në vend dhe duhej të mbante procesverbal për të metat e konstatuara, si dhe të nënshkruante akt marrjet në dorëzim e situacionet pjesore e përfundimtare, për **4 mbikëqyrës**, të vendosë masë **administrative gjobë** si më poshtë:

1. **A.Q.**, me detyrë Shef Seksioni Administrim Pyjeve Korçë, në cilësinë e mbikëqyrësit të kontratës me objekt “Pyllëzim kurora e gjelbër fshati Tushemisht”.
2. **D.A.**, me detyrë Specialist Investim-Punime Korçë, në cilësinë e mbikëqyrësit të kontratës me objekt “Pyllëzim kurora e gjelbër fshati Tushemisht”.

3. P.P, detyrë Specialist Këshillimor Drejtoria e Shërbimit Pyjor SHP Korçë, në cilësinë e mbikëqyrësit të kontratës me objekt “Pyllëzim kurora e gjelbër fshati Tushemisht”.

- Nuk ka nënshkruar situacionet pjesore dhe përfundimtare në monitorimin e kontratës me objekt “Pyllëzim kurora e gjelbër fshati Tushemisht” me fond limit 18,729,530 lekë, në kundërshtim me Manualin e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave “Mbi rregullat dhe kërkesat teknike të trajtimit, përdorimit e shfrytëzimit të pyllit komunal”, Kapitulli III-të “Kontrolli dhe marrja në dorëzim e punimeve”, pasi grupi i specialistëve, i caktuar me urdhër të veçantë të drejtorit të DSHP Korçë, duhej të monitoronte punën në vend dhe duhej të mbante procesverbal për të metat e konstatuara, si dhe të nënshkruante akt marrjet në dorëzim e situacionet pjesore e përfundimtare.

4 – E.M, me detyrë Specialist i nivelit të lartë për supervizim shërbimesh.

- Në transaksionin nr. 42, datë 27.02.2015, në vlerën 1,910,404 lekë me objekt “Situacion pastrimi Janar 2015”, në faturën tatimore nr. 1, datë 31.01.2015 dhe situacionin për periudhën 16.01.2015-31.01.2015, nuk është bazuar DST (lidhja A, B) dhe kontratën datë 16.01.2015, për arsye se janë shtuar zërat e shërbimeve në vlerën **307,575 lekë**.

- Në transaksionin nr. 95, datë 21.04.2015 në vlerën 1,000,000 lekë me objekt shpenzimi “Pastrimi i qytetit muaj Mars 2015, në zërin ”Mirëmbajtje lumi i qytetit” në situacionin e muajit Mars 2015, është situacionuar me afat 31 ditë ose ditë 6.83 ditë **më tepër**, në vlerën **16,037.50 lekë**, në kundërshtim me kontratën datë 16.01.2015, për arsye se, në kontratë është parashikuar volumi 290 ditë/vit ose 24.17 ditë/muaj.

- Në transaksionin nr. 109, datë 11.05.2015, në vlerën 1000,000 lekë me objekt shpenzimi “Pastrimi i Qytetit” për periudhën 01.03.2015-31.03.2015, rezulton se zëri “Ngarkim + transport të ngurtash” në situacionin e muajit Mars 2015, është situacionuar 66 ton ose + 12.66 ton **më tepër** në vlerën **21,794 lekë**, në kundërshtim me kontratën datë 16.01.2015, për arsye se, në kontratë është parashikuar volumi 700 ton/vit ose 53.34 ton/muaj.

- zëri “Pastrim lumi i Qytetit dhe lumit të Vërdovës nga mbeturinat” në situacionin e muajit Mars 2015, është situacionuar për 31 ditë ose 6 ditë **më tepër** në vlerën **14,089 lekë**, në kundërshtim me kontratën datë 16.01.2015, për arsye se, në kontratë është parashikuar 290 ditë në vit ose 24-25 ditë në muaj. Në total vlera prej **359,495.50 lekë përbën dëm ekonomik i arkëtueshëm nga OE “██████████” shpk**.

- Në transaksionin nr. 110, datë 11.05.2015, në vlerën 900,397 lekë me objekt shpenzimi "Pastrimi i qytetit muaj Gusht 2012), u konstatua se zëri i shërbimit “Ngarkim + transport mbeturina familjare” në situacionin e muajit Gusht 2012, është situacionuar me volum 1,060 ton ose 130 ton **më tepër** në vlerën **101,341.50 lekë**, në kundërshtim me kontratën datë 22.12.2008, të ndryshuar me shtesë kontrate datë 21.08.2009, për arsye se, në kontratë është parashikuar volumi 30 ton/ditë x 31 ditë ose 930 ton.

- zëri shërbim “Ngarkim + transport të ngurtash” në situacionin e muajit Gusht 2012, është situacionuar me volum 220 ton ose 28.33 ton **më tepër**, në vlerën **17,959 lekë**, në kundërshtim me kontratën datë 22.12.2008, të ndryshuar me shtesë kontrate datë 21.08.2009, për arsye se, në kontratë është parashikuar volumi 2300 ton/vit ose 191.67 ton/muaj.

- zëri shërbim “Mirëmbajtje lumi i qytetit” në muajin Gusht 2012 është situacionuar me afat 31 ditë ose 10.58 ditë **më tepër** në vlerën **23,995 lekë**, në kundërshtim me kontratën datë 22.12.2008, të ndryshuar me shtesë kontrate datë 21.08.2009, për arsye se, në kontratë është parashikuar volumi 245 ditë/vit ose 20.42 ditë/muaj.

- Në transaksionin nr. 916, datë 31.12.2015, në vlerën 1,539,776 lekë me objekt shpenzimi “Pastrimi i Qytetit” për 01.01.2015-15.01.2015, rezulton se zëri shërbimi “Ngarkim + transport mbeturina familjare” në muajin janar 2015, është situacionuar me volum 480 ton ose **30 ton, më tepër** në vlerën **23,986.50 lekë**, në kundërshtim me kontratën datë 22.12.2008, të ndryshuar me shtesë kontrate datë 21.08.2009, për arsye se, në kontratë është parashikuar volumi 30 ton/ditë x 15 ditë ose 450 ton.

- zëri shërbimi “Ngarkim + transport te ngurtash” në muajin janar 2015, është situacionuar me volum 202 ton ose 106.16 ton, më tepër me diferencë vlerën 67,297 lekë, në kundërshtim me kontratën datë 22.12.2008, të ndryshuar me shtesë kontrate datë 21.08.2009, për arsye se,

në kontratë është parashikuar volumi 2300 ton/vit ose 95.84 ton/15 ditë dhe në total **235,209 lekë**, vlerë e cila përbën dëm ekonomik të arkëtueshëm nga OE “██████████”.

- llogaritja e ndalesave mujore (Janar–Dhjetor 2015), ndalesat për zërat e shërbimeve kryheshin me koeficient 0.25%, 0.50, 0.75 dhe 100%, duke mos zbritur gjithë volumin e shërbimit në masën 100% të volumit të pa kryer. Pa u mbështetur në asnjë dispozitë ligjore apo kontratë volumet e shërbimeve zbriteshin në masën 0.25 %, 0.50 %, 0.75 % të volumit të pa kryer. Nga rillogaritje e pagesave për të gjitha volumet e pakryera për vitin 2015, rezultojë se nuk janë kryer ndalesat, gjë që është shkaktuar një dëm ekonomik për **vlerën 171,372 lekë** të arkëtueshëm nga operatori ekonomik “██████████” sh.p.k.

F. POPOZIM PËR HEQJE LICENCE:

F. 1. Për Ministrinë Zhvillim Urban (Për Komisionin e Licencave)

Mbështetur në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, VKM nr. 759, datë 12.11.2014 “Për Licencimin Profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit” dhe neni 13 dhe 25 dhe pika 1/a, 1/e, neni 41, Kreu VI-të, “Sanksione dhe Dispozita kalimtare”, të “Rregullore për Kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit”, për shkelle të ligjshmërisë në zbatimin e punimeve, në fushën e ndërtimit, i rekomandojmë Komisionit të Licencave, pranë Ministrisë Zhvillim Urban, **Heqjen e së drejtës për ushtrimin e aktivitetit ose pezullimin e përkohshëm në zbatim** (heqjen e Licencës profesionale), për një afat deri nga 2-3 vjet, për **1 mbikëqyrës punimesh** si më poshtë:

- **B.B.**, (nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve me të cilin është lidhur kontrata për mbikëqyrjen e punimeve);

- Nga mos kontrolli i zbatimit të kontratave dhe për punime të pakryera në objektin: “**Sistemim Sheshi Qendër Udënisht-Rruga Nationale**”, ish-Komuna Udënisht, Pogradec, në vlerën 2,504,424 lekë pa TVSH, dhe në objektin: “**Kënd Sportiv për shkollat e fshatrave Lin, Piskupat e Buqez**”, ish-Komuna Udenisht, Pogradec, në vlerën 1,419,800 lekë, pa TVSH.

Për ndjekjen dhe zbatimin e kontrataës me objekt: “**Sistemim Sheshi Qendër Udënisht-Rruga Nationale**”, ish-Komuna Udënisht, ndërmjet Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Udënisht, Pogradec përfaqësuar nga kryetari Durim Toska dhe personik fizik ing. Barjam Balliu i quajtur “Mbikëqyrësi”, me Licence MK 0503 “Për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh ndërtimi”, është lidhur kontrata e shërbimit datë 24.06.2015, **pa përcaktuar vlerën e kontratës**, ndërsa afati i kryerjes së shërbimit për mbikëqyrjen e punimeve është afati i zbatimit të punimeve.

Në dokumentacionin teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit **për punime të pakryera** rezultojnë **më tepër** në vlerën **2,504,424 lekë** pa TVSH, si dhe mungojnë: Raportet e testimit për llaçin, betonin, hekurin dhe bojën të përdorur në objekt; Pasqyra e realizimit të punimeve sipas formatit tip; Dokumentacioni për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjetet mbrojtëse përkatëse; Grafiku i punimeve, veprim në papajtueshmëri me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar, pika 3.2 dhe 3.3, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

Nga punime të pakryera, por të situacionuara e të pasqyruara në librezën e masave është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi “██████████” **shpk** vlera **2,504,424 lekë**, pa TVSH, që përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me Kontratën e sipërmarrjes së punimeve datë 10.12.2014, lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor ish-

Komuna Udënisht, Pogradec përfaqësuar nga ish-kryetari dhe operatorit ekonomik “██████████” sh.p.k, përfaqësuar nga administratori L.K.

Për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës me objekt: “**Kënd Sportiv për shkollat e fshatrave Lin, Piskupat e Buqez**”, ish-Komuna Udënisht, ndërmjet Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Udënisht, Pogradec përfaqësuar nga kryetari dhe personik fizik ing. B.B. i quajtur “Mbikqyrësi”, me Licence MK 0503 “Për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh ndërtimi”, është lidhur kontrata e shërbimit datë 24.06.2015, **pa përcaktuar vlerën e kontratës**, ndërsa afati i kryerjes së shërbimit për mbikëqyrjen e punimeve është afati i zbatimit të punimeve.

Në dokumentacionin teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit **për punime të pakryera rezulton më tepër vlera 1,419,800 lekë**, pa TVSH, si dhe mungojnë: Raportet e testimit për llaçin, betonin, hekurin dhe bojën të përdorur në objekt; Pasqyra e realizimit të punimeve sipas formatit tip; Dokumentacioni e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjetet mbrojtëse përkatëse; Akti i kolaudimit; Akti i marrjes në dorëzim të punimeve; Foto gjatë zbatimit të punimeve; Deklarata teknike e sipërmarrësit; Deklarata teknike e mbikëqyrësit të punimeve; Grafiku i punimeve.

- Mangësitë në zbatimin e punimeve:

Nga likuidimi i punimeve të pakryera por të situacionuara e të pasqyruara në librezën e masave dhe nga verifikimi në terren rezulton se objekti nuk është realizuar dhe nuk janë kryer asnjë lloj punimi për realizimin e kontratës, ndërsa nga sipërmarrësi “██████████” shpk, është përfituar padrejtësisht vlera **1,419,800 lekë**, pa TVSH, që përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Pogradec, veprim në papajtueshmëri me kontratën e sipërmarrjes së punimeve datë 11.11.2014 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Udënisht, Pogradec përfaqësuar nga ish-kryetari dhe operatorit ekonomik “██████████” sh.p.k, përfaqësuar nga administratori P.L, me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar, pika 3.2 dhe 3.3, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, (Njësia e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.
2. Të njoftojë Komisionarin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

****Shënim: Për punonjësit e larguar.***

- Për 14 ish-punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara do të ishte kërkuar masë disiplinore, përkatësisht, për:

1. J.P, me detyrë ish audituese (larguar nga Bashkia Pogradec);
2. S.D, me detyrë Administrator në Njësinë Administrative Trebinjë;
3. A.M, me detyrë Administrator në Njësinë Administrative Dardhas;
4. D.Ç, me detyrë Administrator në Njësinë Administrative Udenisht;

5. Ë.Sh, me detyrë Administrator në Njësinë Administrative Buçimas;
6. D.K, me detyrë Administrator në Njësinë Administrative Çërravë;
7. V.Gj, me detyrë Administrator në Njësinë Administrative Velçan;
8. G.A, me detyrë Administrator në Njësinë Administrative Proptisht;
9. P.K, me detyrë ish Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave larguar nga puna me datë 30.11.2015;
10. K.Gj, me detyrë ish Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit, larguar nga puna me datë 04.08.2015;
11. P.Z, me detyrë ish-Drejtor i Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit larguar nga puna me datë 21.02.2015;
12. V.B, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të kontrollit dhe administrimin e territorit, (në pension);
13. M.Sh, me detyrë ish-Drejtor i Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit, larguar nga puna me datë 31.11.2015.
14. Rr.T, me detyrë ish-Kryetar i Komunës Buçimas.

E. KALLËZIM PENAL

Bazuar në kualifikimet e neneve 248 “Shpërdorimi i detyrës” dhe 258 “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, të Kodit Penal, bëjmë kallëzim penal për:

a. 1. Një titullar i AK dhe Tre anëtarë të KVO;

1. **R.T**, me detyrë ish Kryetar i Komunës Buçimas, në cilësinë e nëpunësit autorizues.
2. **O.S**, me detyrë Përgjegjës i Urbanistikës Komuna Buçimas, në cilësinë e Juristit të Njesisë së Prokurimit, për shkelje në **7 proceduar** prokurimi.
3. **E.P**, me detyrë Drejtor i Burimeve e Shërbimeve Njerëzore/Jurist, në cilësinë e Specialistit në Njësinë e Prokurimit.
4. **I.K**, me detyrë Kryeinspektor i Përgjithshëm Vendor Komuna Buçimas, në cilësinë e Specialistit në Njësinë e Prokurimit.

a. 2. L.M, me detyrë ish-Kryetar Bashkie në cilësinë e ish-Titullarit të Autoriteti Kontraktor.

a. 3. Një mbikëqyrës punimesh;

6. B.B, (nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve me të cilin është lidhur kontrata për mbikëqyrjen e punimeve);

pasi kanë kryer veprime të kundërligjshme të cilat referuar përmbajtjes së dispozitës penale, neni 248 dhe neni 258 i Kodit Penal, mbartin elementët e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, si dhe në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, pikat 3.2 dhe 3.3 të Udhëzimit të KM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

Shënim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

KRYETAR